

KALLËZIM PENAL

Tiranë me datë 19.06.2020.

KALLZUES:

1. Znj. Antoneta Sevdari
2. Z. Ervin Metalla
3. Z. Elision Sadiku

OBJEKTI: Kallëzim penal ndaj shtetasve:

1. **Luan Daci**, me detyrë gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për kryerjen e veprave penale të: “Falsifikimi i dokumenteve”, “Fshehja e të ardhurave” dhe “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara, respektivisht, nga nenet 186/2, 180 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.
2. **Ardian Hajdari**, me detyrë gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, për kryerjen e veprave penale të: “Falsifikimi i dokumenteve”, “Fshehja e të ardhurave” dhe “Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara, respektivisht, nga nenet 186/2, 180 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 283 i Kodit të Procedurës Penale.

DREJTUAR : Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë.

I/e nderuar z/znj. Prokuror/e!

Ky kallëzim penal paraqitet para Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, referuar nenit 75/a(c) të Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo është prokuroria kompetente për ndjekjen penale të Gjyqtarëve Kushtetues, siç janë të kallëzuarit Luan Daci dhe Ardian Hajdari.

I. Sfondi historik i rrethanave.

1. Me vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me nr. 83/2017, datë 17.06.2017, shtetasit Luan Daci dhe Ardian Hajdari janë përzgjedhur gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Referuar pikës 6 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, Presidenti i Republikës ose, në mënyrë subsidiare, Avokati i Popullit është përgjegjës për të organizuar procesin e hapur dhe transparent të aplikimit për pozicionin e anëtarit të Komisionit, gjyqtarit në Kolegjin e Apelimit, si dhe të Komisionerit Publik
2. Nga aktet e dorëzuara prej tyre pranë Avokatit të Popullit, por edhe nga të dhënat që kemi mundur të sigurojmë nga burime të hapura të informacionit, rezulton se ekzistojnë dyshime të bazuara se shtetasit Luan Daci dhe Ardian Hajdari kanë kryer veprat penale të: “Falsifikimi i dokumenteve”, “Fshehja e të ardhurave” dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara, respektivisht, nga nenet 186/2, 180 dhe 257/a/2 të Kodit Penal.
3. Në bazë të nenit 7 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Avokati i Popullit, me datë 26.01.2017, ka shpallur thirrjen për shprehjen e interesit për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Me datë 13.02.2017, ky institucion i ngarkuar nga ligji ka miratuar protokollin (rregulloren) e vlerësimit të plotësimit të kriterëve formale dhe kushteve të zgjedhshmërisë nga kandidatët aplikues.
4. Në bazë të këtij akti rregullator, pjesa më e madhe e kushteve të zgjedhshmërisë do të verifikoheshin **në bazë të vetëdeklarimit** apo dokumenteve mbështetëse të **dorëzuara nga vetë kandidati**. Me datë 17.02.2017 Avokati i Popullit, pasi ka bërë verifikimet e kushteve të zgjedhshmërisë, i ka përcjellë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit listat e kandidatëve. Nga kjo listë rezulton se 29 aplikantë i plotësonin kriteret ligjore dhe 163 kandidatë nuk i plotësonin ato. Më pas, me datë 03.03.2017, Avokati i Popullit i ka përcjellë dy listat e sipërcituara në Kuvend, sëbashku me rekomandimet e ONM-së. Sqarojmë se **emrat e z. Luan Daci dhe z. Ardian Hajdari, fillimisht, janë përcjellë në Kuvend në listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë kriteret formale.**
5. Në sqarimet që shoqërojnë këtë listë thuhet që: z. Daci ka aplikuar për të gjitha pozicionet, mungojnë dokumentet si më poshtë vijon: Nga dokumentacioni i paraqitur nuk plotësohet **kriteri i vjetërsisë në punë, sipas germës b) pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 84/2016 (libreza e punës), mungon licenca e avokatisë, mungon vërtetimi i gjëndjes gjyqësore, si dhe mungon vërtetimi që nuk është në proces hetimor.**
6. Ndërsa për z. Hajdari, i cili ka aplikuar për gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mungojnë dokumentet si më poshtë vijon: Nga dokumentacioni i paraqitur nuk **plotëson kriterin e vjetërsisë në punë**, për asnjë nga pozicionet e germës b), pika 1 të nenit 6 të ligjit 84/2016, mungon vlerësim pune, mungon vërtetimi i gjëndjes gjyqësore, mungon formulari integritetit, sipas ligjit nr. 138/2015, si dhe mungon vërtetimi që nuk është në proces hetimor.
7. Me datë 17.03.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kthen edhe një herë tek Avokati i Popullit procedurën, për riplotësim dokumentacioni dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit, sipas vendimit nr. 18/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

8. Pas rihapjes së procedurës, është caktuar një afat i ri për plotësimin e dokumentacionit dhe, me datë 30.03.2017, Avokati i Popullit ka përcjellë në Kuvend dy lista: njëra me 84 kandidatë që i plotësojnë kushtet formale dhe tjetra me 109 kandidatë që nuk i plotësojnë kushtet. Nuk ka asnjë shpjegim pse një kandidat që nuk i plotëson kushtet formale herën e parë, i plotëson ato një muaj më pas.

II. Faktet të cilat ngrejnë dyshime për kryerjen nga i kallëzuari Luan Daci të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

9. Nga aktet bashkëlidhur këtij kallëzimi krijohen dyshime se z. Luan Daci ka paraqitur dokumente me përmbajtje të falsifikuar, para Avokatit të Popullit, me qëllim që të zgjidhej anëtar i institucioneve të rivlerësimit. Pra, krijohen dyshime se ky shtetas ka konsumuar në këtë mënyrë elementët e veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve”, nga e cila kanë ardhur pasoja të rënda, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Më konkretisht:
- Në kërkesën e datës 03.02.2017 drejtuar Avokatit të Popullit, me qëllim që të vërtetonte se përmbushte kushtin e parashikuar në germën dh) të pikës 1 të nenit 6 të ligjit 84/2016, “*ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit*”, ai ka paraqitur **të dhëna të pavërteta**, duke deklaruar se ndaj tij nuk është marrë masa disiplinore e largimit nga puna;
 - Rezulton se Luan Daci është shkarkuar nga detyra me masë disiplinore, sipas vendimit nr. 06, datë 24.12.1997 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me motivacionin për “*Shkelje të ligjit dhe paafësi në detyrë*”. Vetëm tre muaj përpara se ai të kandidonte për anëtar i Kolegjit të Apelit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mbledhjen e zhvilluar me datë 18.11.2016, e ka skualifikuar atë nga gara, për shkak se nuk plotëson kushtet ligjore për vendet vakante të shpalluara nga ky institucion, për pozicionin e gjyqtarit të shkallës së parë, pikërisht për faktin se ai me vendimin nr. 06, datë 24.12.1997, ishte shkarkuar nga detyra, sipas motivacionit të sipërcituar;
 - Në Rregulloren e hartuar nga Avokati i Popullit, ose të ashtuquajturin “**Protokolli i procedurave të punës për të vlerësuar se cili prej kandidatëve plotëson kriteret formale për institucionet rivlerësuese**”, ndër të tjera, parashikohet se: “Për kërkesën e parashikuar në nenin 6, paragrafi 1 dh) të ligjit 84/2016, se “kandidati nuk është pushuar nga puna për arsye disiplinore ose është aktualisht nën ndonjë masë disiplinore”, **është i mjaftueshëm vetëdeklarimi**. Pra, vetë akti rregullator i një institucioni shtetëror kompetent, i hartuar dhe miratuar në bazë dhe për zbatim të ligjit, i ka atribuar vlerë vërtetuese apo zyrtare, pikërisht vetëdeklarimit të subjektit, në kërkesën e tij për shprehje interesi për një nga vendet vakante të institucioneve të rivlerësimit;
 - Nga procesverbali i datës 02.06.2017, i mbledhjes së zhvilluar në Kuvend nga Komisioni Ad Hoc me 6 anëtarë, për përzgjedhjen e kandidatëve për krijimin e institucioneve të rivlerësimit, rezulton se, kur z. Luan Daci është pyetur nga deputetja

Vasilika Hysi, anëtare e Komisionit Parlamentar Ad Hoc, lidhur me atë se pse është larguar nga detyra e gjyqtarit, ai është përgjigjur: “Kam ikur me doreheqje.....”¹.

- Veprimet e kryera prej të kallëzuarit Luan Daci, tregojnë më së miri anën subjektive të mënyrës se si ai ka vepruar që në fillim, nëpërmjet pasqyrimit në kërkesën e tij drejtuar Avokatit të Popullit, dokument me vlerë ligjore sa i takon vërtetësisë së të dhënave që tregojnë përmbushjen e kritereve formale për aplikim, të të dhënave të pavërteta, siç është mosqënia e tij i larguar nga puna për arsye disiplinore, ndërkohë që ishte krejt e kundërta.
10. **Përfundime ligjore:** Nga analiza e fakteve të sipërcituara rezulton se lidhur me kërkesën e z. Luan Daci për shprehje interesi për të plotësuar vendet vakante të institucioneve të rivleresimit, kërkesë e cila përmban vetëdeklarimin e tij se nuk është larguar ndonjëherë nga puna për arsye disiplinore, ka të dhëna të mjaftueshme dhe të rëndësishme, të cilat krijojnë dyshimin e fortë se z. Luan Daci ka kryer veprën penale të: “Falsifikimi i dokumenteve”, e cila ka sjellë pasoja të rënda, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal, i cili parashikon se: “Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet”.
11. **Kërkesa në fjalë përbën dokument**, pasi vetë akti rregullator i Avokatit të Popullit (Protokolli i vlerësimit të plotësimit të kushteve dhe kritereve nga kandidatët) i ka dhënë vetëdeklarimit vlerën vërtetuese ligjore të konsiderimit të plotësuar të kriterit të parashikuar nga neni 6, paragrafi 1, pika dh), e ligjit 84/2016. Në këtë rast, falsifikimi paraqitet jo mekanik, me ndryshime, korrigjime, prishje apo fshirje të dokumentit, por konsiston në një falsifikim intelektual, në paraqitjen e të dhënave të rreme në një dokument që ka vlerë vërtetuese për plotësimin e kushteve të zgjedhshmërisë.
12. Pasoja e ardhur nga veprimi i të kallëzuarit është e rëndë, sepse si pasojë e paraqitjes së dokumenteve me përmbajtje të rreme ai ka çuar në lajthitje institucionin përgjegjës përzgjedhës, duke e zgjedhur atë anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe duke cënuar rëndë, në këtë mënyrë, interesat e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 6 i KEDNJ-së (sespe nuk janë gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj), duke rrezikuar në këtë mënyrë në tërësi të gjithë procesin para GJEDNJ-së, si dhe duke cënuar besimi i publikut tek reforma në drejtësi.
- III. Faktet të cilat ngrejnë dyshime për kryerjen nga i kallëzuari Luan Daci të veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.**
13. Gjithashtu në kërkesën/deklaratën e tij të datës 03.02.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, me qëllim që të vërtetonte se përmbushte kushtin e parashikuar në germen b), pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016, “të ketë përvojë jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës”, i kallëzuari Luan Daci ka deklaruar se ka ushtruar profesionin e avokatit për një periudhë 17 vjeçare.

¹ Shih faqen 52, 53 të këtij procesverballi.




14. Lidhur me plotësimin e këtij kriteri, kërkesës së tij të datës 03.02.2017, ky shtetas i ka bashkalidhur vetëm dokumentin "Leje e ushtrimit të profesionit" me nr. 888, datë 27.03.2000 dhe asnjë dokument tjetër, siç ka theksuar edhe vetë institucioni i Avokatit të Popullit, p.sh. librezën e punës apo librezë e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë dokumentet që tregojnë realisht periudhën e punës dhe të pagimit të sigurimeve shoqërore, gjatë kohës së ushtrimit të profesionit. Për këtë arsye Komisioni i ngritur pranë Avokati të Popullit, me qëllim verifikimin e kushteve të zgjedhshmërisë së tij, ka vendosur se ky aplikant nuk e vërteton me dokumentacion kushtin e përvojës profesionale;
15. Pas rihapjes së garës, ky shtetas ka paraqitur një vërtetim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, sipas të të cilit shtetasi Luan Daci është anëtar i Dhomës së Avokatisë prej vitit 2000, nuk ka marrë masë disiplinore dhe ka shlyer detyrimet financiare ndaj Dhomës së Avokatisë.
16. Zotërimi i lejes së ushtrimit të profesionit të avokatisë nuk vërteton ushtrimin faktik të profesionit. Koha e fillimit dhe kohëzgjatja e profesionit të avokatit (i cili është veprimtari ekonomike), duhet të rezultojë nga të dhënat e pasqyruara në organet tatimore dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të dhëna këto të dorëzuara nga subjekti tatimpagues, i rregjistruar rregullisht dhe i pajisur me certifikatën tatimore përkatëse. Mbi bazën e tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore për çdo muaj pune, plotësohet librezë e punës që Komisioni i Avokatit të Popullit shënon apo thekson në dokumentin që përshkruan arsyet e skualifikimit të këtij kandidati, herën e parë.
17. Nga të dhënat publike rezulton se i kallëzuari Luan Daci është rregjistruar për herë të parë në organet tatimore, për të ushtruar profesionin e avokatit në datën 18.10.2007, duke u pajisur me certifikatën tatimore me numrin unik i identifikimit të subjektit K72218029T. Përpara kësaj date ai nuk ka qenë i rregjistruar në organet tatimore, nuk ka paguar sigurimet shoqërore për ushtrimin e profesionit të avokatit dhe, për rrjedhojë, ai nuk vërteton ligjërisht që ka ushtruar funksionin përpara datës 18.10.2007, pra, *ipso legge* nuk vërtetohet se ky shtetas ka të paktën 15 vjet pune si avokat. **Megjithatë**, edhe nëse merret i mirëqenë pretendimi i tij se ka ushtruar profesionin e avokatit edhe përpara datës 18.10.2007, atëherë kjo ka ndodhur në kundërshtimin me ligjin, pasi **ky fakt provon se ai ka shkelur gjatë kësaj periudhe legjisllacion tatimor, duke kryer evazion fiskal.**
18. Bazuar në sa më lart, i kallëzuari Luan Daci ose ka pasqyruar të dhëna të rreme në aplikimin e tij të datës 03.02.2017, paraqitur përpara Avokatit të Popullit, për shkak se ka deklaruar se ka **ushtruar profesionin e avokatit për një periudhë jo më pak se 15 vjet**, ose e ka ushtruar atë vërtetë, por ka fshehur të ardhurat e krijuara nga ky aktivitet, për të shmangur pagimin e detyrimeve tatimore, në kuptim të nenit 180 të Kodit Penal.
19. Kështu i kallëzuari Luan Daci pretendon se ka ushtruar profesionin e avokatit nga muaji Mars i vitit 2000, deri në momentin e zgjedhjes së tij si anëtar i KPA-së, në Qershor të vitit 2017. **Ky informacion, i kombinuar edhe me atë që buron nga deklarata e tij e pasurisë, para fillimit të ushtrimit të detyrës, krijojnë dyshime se ai nuk ka deklaruar të ardhurat e realizuara prej tij në organet tatimore**, deri në Qershor të vitit 2017. Theksojmë se, pas ndryshimeve që u bënë në Kodin Penal, nëpërmjet ligjit nr. 144/2013, datë 2.5.2013, vepra penale "Fshehja e të ardhurave" parashikohet si krim dhe nuk është më e nevojshme që, për lindjen e përgjegjësisë penale për konsumimin e kësaj vepre penale, të jetë marrë paraprakisht e masa administrative.

- Luan Daci është zgjedhur si anëtar i KPA-së në fund të muajit Qershor të vitit 2017. Nga 1 Janari i vitit 2017, deri në datën e zgjedhjes, ai ka ushtruar profesionin e avokatit për pothuaj gjashtë muaj.
- Bazuar në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, I ndryshuar, si dhe ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtyre ligjeve, nga Muaji janr i vitit 2011, çdo avokat, si profesionist i lirë, brenda datës 10 të çdo muaji, duhet të bëjë deklaram elektronik të librave të shitjes dhe librave të blerjes, për muajin paraardhës. Ky raportim bëhet detyrimisht edhe nëqoftëse profesionisti i lirë (në rastin konkret avokati) nuk ka kryer asnjë veprim shitje apo blerje, pra, deklarimi bëhet duke shënuar 0 të ardhura. Për avokatët që kanë kryer veprimtari gjatë muajit është e rëndësishme të kenë plotësuar faturën e shitjes, për çdo shitje të realizuar të shërbimit të avokatisë. Sipas kuadrit të sipërcituar ligjor, profesionistët e lirë, ndryshe nga bizneset e tjera, lëshojnë faturë me TVSH, duke filluar nga e ardhura 0. Pra, sado e vogël të jetë e ardhura mujore apo vjetore e subjektit fizik, si profesionistë .
- Gjithashtu, brenda datës 14 të çdo muaji, pasi bëhet deklarimi elektronik i TVSH-së për muajin paraardhës, nga sistemi gjenerohet deklarata e TVSH-së, në dy kopje dhe, brenda kësaj date, duhet të kryhen pagesat pranë një banke.
- Në përfundim të çdo tremujori, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bëhet deklarimi elektronik i detyrimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tremujorin dhe pagesa pranë një banke e këtyre detyrimeve, sipas deklaratës së gjeneruar për këtë qëllim nga sistemi. Një kopje e borderosë së sigurimeve shoqërore e shëndetësore të tremujorit depozitohet në bankë, sëbashku me deklaratën përkatëse².
- Referuar deklaramit të pasurisë së Luan Dacit, përpara fillimit të detyrës³, rezulton se, në faqen ku pasqyrohen: “Angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, ai ka shënuar: “Nuk kam angazhim dhe veprimtari që të këtë sjellë të ardhura në asnjë institucion, organizatë apo aktivitet, as unë as bashkëshortja as fëmijët”.
- Të dhënat e sipërcituara, të analizuara sëbashku, ngrejne dyshime të forta se i kallëzuari Luan Daci, në vazhdimësi, edhe pas regjistrimit të tij në organet tatimore, nuk ka deklaruar edhe paguar detyrime tatimore, duke konsumuar në këtë mënyrë elementët e veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.
- Bashkëlidhur këtij kallëzimi po paraqesim si dokument që përben një të dhënë për kryerjen prej tij të kësaj veprë penale, edhe kopje të vendimit të datës 14.02.2017, dhënë nga Gjykata e Shkallës së parë Tiranë, ndaj të pandehurit Ben Lika, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180/3 i Kodit Penal, ku avokat i zgjedhur i të pandehurit në këtë çështje penale ka qenë pikërisht avokat Luan Daci⁴.
- Nga të dhënat e siguruara vetëm mbi bazën e dokumenteve të aksesueshëm publikisht, dyshohet se i kallëzuari Luan Daci, nga ana objektive, e ka kryer veprën penale të

² Këtë shpjegim ligjor, në ndihmë të të gjithë avokatëve e ka publikuar edhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në faqen e saj zyrtare në rubrikën “Procedurat tatimore”.

³ Të dhëna të publikua nga Open Data Albania.

⁴ Dijenia mbi këtë çështje, rezulton nga fakti se kallëzuesja Antoneta Sevdari ka përfaqësuar organin e akuzës në disa seanca gjyqësore të zhvilluara në gjykatë ndaj këtij të pandehuri.

“Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, nëpërmjet mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme (moslëshimit të faturave tatimore dhe mosdeklarimit të tyre në sistemin tatimor, çdo muaj), sikurse kërkonte legjislacionit në fuqi. Në deklaratën e tij të pasurisë, ai ka deklaruar se: “Nuk kam angazhim dhe veprimtari që të këte sjellë të ardhura në asnjë institucion, organizatë apo aktivitet, as unë as bashkëshortja as fëmijët”. Nga ana subjektive, kjo vepër penale rezulton të jetë kryer me dashje, me qëllim mospagimin e detyrimeve tatimore.

IV. Faktet të cilat ngrejnë dyshime për kryerjen nga i kallëzuari Luan Daci të veprës penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.




20. Në deklarimin e tij të pasurisë, para fillimit të ushtrimit të detyrës, i kallëzuari Luan Daci ka deklaruar:

- ✦ gjëndje cash -1,000,000 lekë;
- ✦ 2000 euro në llogari bankare;
- ✦ 150,000 lekë në llogari bankare;
- ✦ Gjithashtu deklarohen edhe nga bashkëshortja e tij gjëndje në llogari bankare rreth 530,000 lekë.

21. Në këtë kontekst rrethanash, duke qenë se ky shtetas nuk ka krijuar fare të ardhura, ashtu siç deklaroi në deklaratën e tij të pasurisë, përpara fillimit të detyrës, natyrshëm lind pyetja se si janë përballuar prej tij shpenzimet për jetesë, për vete dhe për familjen e tij; kush është burimi i të ardhurave me të cilat janë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat paguhen detyrimisht, pavarësisht realizimit apo jo të të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit; si janë paguar taksat fikse të ushtrimit të aktivitetit etj. Po kështu, nuk deklarohet në deklaratën e tij të pasurisë burimi i krijimit të likujditetit.

22. Nga sa më sipër, krijohen dyshime se shtetasi Luan Daci ka fshehur burimin e krijimit të pasurisë së tij; të krijohen dyshime se ky shtetas ka fshehur të ardhurat reale të realizuara nga ushtrimi i profesionit të avokatit. Duke qenë se këto të ardhura nuk janë deklaruar në tatime, për të shmangur pagesën e detyrimeve tatimore, për rrjedhojë, nuk janë deklaruar as në deklaratën e tij të pasurisë.

23. Pra, nga ana objektive, vepra penale e parashikuar nga neni 257/a/2 e Kodit Penal, dyshohet të jetë kryer prej të kallëzuarit Luan Daci, nëpërmjet veprimeve të kundraligjshme, të cilat konsistojnë në mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë



së tij, si dhe mosdeklarimin e të ardhurave të siguruara nga avokatia, apo veprimtari tjetër e padeklaruar, veprim i kryer me dashje të drejtëpërdrejtë.




V. Faktet të cilat ngrejnë dyshime për kryerjen nga i kallëzuari Ardian Hajdari të veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

24. Nga kërkimet e kryera nga ne kallëzuesit, rezulton se ka të dhëna, nga të cilat krijohen dyshime se i kallëzuari Ardian Hajdari ka paraqitur pranë Avokatit të Popullit, dokumente me përmbajtje të falsifikuar, me qëllim që të zgjidhej anëtar i institucioneve të rivlerësimit. Pra, krijohen dyshime se ky shtetas ka konsumuar në këtë mënyrë elementët e veprës penale të “Falsifikimi i dokumenteve”, nga e cila kanë ardhur pasoja të rënda, sikurse parashikon neni 186/2 i Kodit Penal.
25. Ashtu siç u theksua më sipër, Rregullorja e hartuar nga Avokati i Popullit, kërkon që kandidatët të vetëdeklarojnë me qëllim përmbushjen e kushteve të zgjedhshmërisë, sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016.
26. Në germën b) të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se kandidati duhet “të ketë përvojë jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, **avokat**, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës”. I kallëzuari Ardian Hajdari ka deklaruar se ka ushtruar profesionin e avokatit për një periudhë 17 vjeçare.
27. Konkretisht, **gjatë intervistimit në Kuvend, Ardian Hajdari ka deklaruar të dhëna të pavërteta, duke u shprehur se ka ushtruar funksionin e avokatit për 17 vite**⁵. Për vërtetimin e përvojes së tij profesionale si avokat, Ardian Hajdari ka paraqitur 17 leje vjetore të lëshuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, si dhe një vërtetim të lëshuar nga Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë
28. Ndryshe nga sa ka deklaruar para Komisionint Ad Hoc të Kuvendit, ai në CV-në e tij ka pasqyruar se ka ushtruar profesionin e avokatit nga viti 2002-2004 dhe nga viti 2006 e në vazhdim. Pra, edhe sipas të dhënave⁶ të CV-së së tij, ai ka ushtruar profesionin e avokatit për një periudhë maksimale prej 13 vitesh. Përvoja tjetër profesionale e paraqitur në CV-në e të kallëzuarit Ardian Hajdari, ajo e juristit në Hidrocentralin e Komanit dhe Bashkinë e Vaut të Dejës nuk përfshihet në grupin e profesioneve të parashikuara në germën b) të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016. Ndaj duke njohur këtë fakt, ai ka deklaruar të dhëna të pavërteta në Kuvend, duke gënjyer⁷ se ka ushtruar profesionin e avokatit për 17 vite, pasi përgjatë një pjese të kësaj periudhe ai nuk mund të punonte jurist në administratë dhe njëkohësisht të ushtronte veprimtarinë tregtare të ofrimit të shërbimit të avokatisë.
29. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën me nr. 1825/2, datë 06.06.2019, në përgjigje të kërkesave të përsëritura të kallëzueses Antoneta Sevdari, ka dërguar edhe

⁵ Shiko deklarimin e tij në faqen përkatëse të procesverbalit

⁶ Të dhëna që, siç edhe me poshtë do të sqarohet, nuk janë të sakta.

⁷ Shiko faqen 31 të procesverbalit të datës 02.06.2007, ku pyetjes se deputetit Eduard Halimi, kandidati Ardian Hajdari i përgjigjet se ka punuar gati 17 vjet si avokat (që nga maji i vitit 2000).





disa dokumente të paraqitura pranë Avokatit të Popullit, nga kandidati Ardian Hajdari. Dokumentacioni i dorëzuar mbi kërkesën e kallëzueses nuk ka qenë i plotë, pasi mungojnë kërkesa e aplikuesit Ardian Hajdari, mungon deklarata e tij, sipas nenit 6 të ligjit nr. 84/2016⁸. Këto dokumente duhet të administrohen gjatë hetimit nga organi i akuzës dhe të verifikohen faktet e deklaruara prej tij. Kjo pasi krijohen dyshime se, në kërkesat apo deklaratat e paraqitura prej tij (Vetëdeklarimi i plotësimit të kushteve të zgjedhshmërisë, kusht i përcaktuar në Rregulloren/Protokollin e miratuar nga Avokati i Popullit, në Bashkëpunim me ONM-në), i kallëzuari Ardian Hajdari, edhe pse nuk i plotësonte kushtet e zgjedhshmërisë, ka kaluar filtrin e përzgjedhjes, çka llogjikisht të çon në përfundimin se në këto dokumente (kërkesë, deklaratë), të cilat ne nuk kemi mundur t'i administrojmë, për shkak se nuk na janë dhënë, ai duhet të ketë pasqyruar të dhëna të rreme në lidhje me kushtet e parashikuara nga neni 6 i ligjit nr. 84/2016.

VI. Faktet të cilat ngrejnë dyshime për kryerjen nga i kallëzuari Ardian Hajdari të veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

30. Nga të dhënat publike të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit/Biznesit, rezulton se Ardian Hajdari është rregjistruar për herë të parë në organet tatimore, për të ushtruar profesionin e avokatit, në datën 27.04.2007⁹, duke u pajisur edhe me certifikatën përkatëse tatimore dhe me numrin unik të identifikimit të subjektit K766270020. Përpara kësaj date, Ardian Hajdari nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe nuk rezulton të ketë paguar sigurimet shoqërore për ushtrimin e profesionit të avokatit.
31. Nga aktet bashkëlidhur këtij kallëzimi rezultojnë të dhëna të mjaftueshme për t'i atribuar shtetasit Ardian Hajdari edhe elementët e figurës së veprës penale të “Fshehja e të ardhurave”, e parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal. Kjo pasi në deklarin e tij të pasurisë, para fillimit të ushtrimit të detyrës si gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Ardian Hajdari nuk ka deklaruar krijimin e të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë.
32. Pyetjes së deputetit Eduard Halimi, gjatë intervistimit para Komisionit Ad Hoc në Kuvend, kandidati Ardian Hajdari i është përgjigjur se numri i çështjeve që ai përfaqëson gjatë një viti është rreth 100 çështje. Ai ka ushtruar profesionin e avokatit në vitin 2017, për pothuaj 6 muaj dhe, edhe pse do të duhet të kishte pasur rreth 50 çështje, ai ka deklaruar zero të ardhura.
33. Kështu i kallëzuari Ardian Hajdari pretendon se ka ushtruar profesionin e avokatit që nga viti 2000, deri në momentin e zgjedhjes së tij si anëtar i KPA-së, në Qershor të vitit 2017. **Ky informacion, i kombinuar edhe me atë që buron nga deklarata e tij e pasurisë, para fillimit të ushtrimit të detyrës, krijojnë dyshime se ai nuk ka deklaruar të ardhurat e realizuara prej tij në organet tatimore.** Theksojmë se, pas ndryshimeve që u bënë në Kodin Penal, nëpërmjet ligjit nr. 144/2013, datë 2.5.2013, vepra penale “Fshehja e të ardhurave” parashikohet si krim dhe nuk është më e

⁸ Të cilat janë për anëtarët e tjerë.

⁹ Bashkalidhur certifikata tatimore nga web.



nevojshme që, për lindjen e përgjegjesisë penale për konsumimin e kësaj vepre penale, të jetë marrë paraprakisht e masa administrative.

34. Ardian Hajdari është zgjedhur si anëtar i KPA-së, në fund të muajit Qershor të vitit 2017. Nga Janari i vitit 2017, deri në datën e zgjedhjes, ai ka ushtruar profesionin e avokatit për këtë vit, për pothuaj gjashtë muaj dhe nuk ka deklaruar asnjë të ardhur nga kjo veprimtari, pavarësisht se në Kuvend ka deklaruar se ka mbron/përfaqëson 100 çështje në vit.
35. Bazuar në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", I ndryshuar, si dhe ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të këtyre ligjeve, nga Muaji janr i vitit 2011, çdo avokat, si profesionist i lirë, brenda datës 10 të çdo muaji, duhet të bëjë deklarim elektronik të librave të shitjes dhe librave të blerjes, për muajin paraardhës. Ky raportim bëhet detyrimisht edhe nëqoftëse profesionisti i lirë (në rastin konkret avokati) nuk ka kryer asnjë veprim shitje apo blerje, pra, deklarimi bëhet duke shënuar 0 të ardhura. Për avokatët që kanë kryer veprimtari gjatë muajit është e rëndësishme të kenë plotësuar faturën e shitjes, për çdo shitje të realizuar të shërbimit të avokatisë. Sipas kuadrit të sipërcituar ligjor, profesionistët e lirë, ndryshe nga bizneset e tjera, lëshojnë faturë me TVSH, duke filluar nga e ardhura 0. Pra, sado e vogël të jetë e ardhura mujore apo vjetore e subjektit fizik, si profesionistë .
36. Gjithashtu, brenda datës 14 të çdo muaji, pasi bëhet deklarimi elektronik i TVSH-së për muajin paraardhës, nga sistemi gjenerohet deklarata e TVSH-së, në dy kopje dhe, brenda kësaj date, duhet të kryhen pagesat pranë një banke.
37. Në përfundim të çdo tremujori, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bëhet deklarimi elektronik i detyrimeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tremujorin dhe pagesa pranë një banke e këtyre detyrimeve, sipas deklaratës së gjeneruar për këtë qëllim nga sistemi. Një kopje e borderosë së sigurimeve shoqërore e shëndetësore të tremujorit depozitohet në bankë, sëbashku me deklaratën përkatëse¹⁰.
38. Referuar deklaramit të tij të pasurisë, para fillimit të ushtrimit të detyrës¹¹, rezulton se i kallëzuari Ardian Hajdari, në faqen ku pasqyrohen: "Angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre", nuk ka shënuar asnjë të dhënë, pra, asnjë të ardhur.
39. Të dhënat e lartpërmendura, të analizuara sëbashku, ngrejnë dyshime të forta se shtetasi Ardian Hajdari, në vazhdimësi, edhe pas regjistrimit të tij në organet tatimore, nuk ka deklaruar edhe paguar detyrime tatimore, duke konsumuar në këtë mënyrë elementët e fihurës së veprës penale të "Fshehja e të ardhurave", të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.
40. Bashkëlidhur këtij kallëzimi po paraqesim disa të dhëna, nëpërmjet të cilave tregohen indicje për kryerjen e veprës penale të "Fshehja e të ardhurave", parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, që konistojnë në kopje të disa vendimeve gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Apelit Shkodër, ku avokat i zgjedhur i palëve në këto çështje gjyqësore ka qënë edhe avokat Ardian Hajdari¹².

¹⁰ Këtë shpjegim ligjor, në ndihmë të të gjithë avokatëve e ka publikuar edhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në faqen e saj zyrtare në rubrikën "Procedurat tatimore".

¹¹ Të dhëna të publikua në Open Data Albania

¹² Dijenia mbi këtë çështje, rezulton nga fakti se kallëzuesja Antoneta Sevdari ka përfaqësuar organin e akuzës në disa seanca gjyqësore të zhvilluara në gjykatë, ndaj këtij të pandehuri

41. Nga të dhënat e siguruara, vetëm mbi bazën e dokumenteve të aksesueshëm publikisht, dyshohet se i kallwzuar Ardian Hajdari, nga ana objektive, e ka kryer veprën penale të “Fshehja e të ardhurave”, nëpërmjet mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme çdo muaj, mosdeklarimi i pasqyrave financiare (të ardhurave dhe shpenzimeve), sipas legjislacionit në fuqi. Në deklarimin pasurisë për vitin 2017 ai nuk ka deklaruar të ardhura, të ardhura përgjatë vitit 2017. Nga ana subjektive, kjo veprë penale dyshohet të jetë kryer me dashje, me qëllim mospagimin e detyrimeve tatimore.

VII. Faktet të cilat ngrejné dyshime për kryerjen nga i kallëzuar Ardian Hajdari të veprës penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal.

42. Në deklarimin e tij të pasurisë, para fillimit të ushtrimit të detyrës si gjyqtar në KPA, Ardian Hajdari ka deklaruar:

- ✦ Apartament banimi me sipërfaqe 75 m² (blerë 1/8 pjesë në vlerën 200.000 lekë në vitin 2009);
- ✦ Automjet me vlerë 3000 Euro, i blerë në vitin 2007;
- ✦ Depozitë 8000 euro, në llogari bankare, çelur në vitin 2009;
- ✦ Depozitë 400.000 lekë, në llogari bankare, çelur në vitin 2009;
- ✦ Depozitë 4000 Dollarë, në llogari bankare, çelur në vitin 2009;
- ✦ Llogar rrjedhëse në shumën 1.539.31 lekë;
- ✦ Të gjitha me burim krijimi nga puna nga avokatia, por gjatë vitit 2017 janë deklaruar zero të ardhura.

43. Ky shtetas nuk ka deklaruar fare të ardhura gjatë vitit 2017. Në kushtet kur, sipas deklarimit të tij gjatë intervistimit në Kuvend, në cilësinë e avokatit ai ka përfaqësuar/mbrojtur një numër shumë të lartë çështjesh gjyqësore, krijohen dyshime se ai ka krijuar të ardhura nga avokatia gjatë vitit 2017, por nuk i ka deklaruar në tatime dhe, si rrjedhim, nuk i ka deklaruar as në deklaratën e tij të pasurisë.

44.

45. Në këto rrethana, natyrshëm lind pyetja se si janë përballuar prej tij shpenzimet për jetesë për vete edhe për familjen e tij; kush është burimi i të ardhurave me të cilat janë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat paguhen detyrimisht, pavarësisht realizimit apo jo të të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit; si janë paguar taksat fikse të ushtrimit të aktivitetit etj.

VIII. Kërkimet përfundimtare.

46. Bazuar në sa u parashtrua më lart në këtë kallëzim, kërkohmë regjistrimin e procedimit penal ndaj shtetasve Luan Daci dhe Ardian Hajdari, për veprat penale që i atribuohen, si dhe administrimin gjatë hetimit të dokumentacionit të poshtëshënuar:

- Administrim e dokumentacionit nga Avokati i Popullit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, për të verifikuar faktet e pasqyruara në kërkesën/deklaratën dhe çdo dokument tjetër të paraqitur prej secilit prej tyre, përpara Avokatit të Popullit;
- Informacion në të gjitha gjykatat, por kryesisht ato në Tiranë dhe Shkodër, për proceset gjyqësore ku Ardian Hajdari dhe Luan Daci kanë marrë pjesë në cilësinë e avokatit, për periudhën 2011-2017;
- Administrim i Librave të blerjes dhe të shitjes së personit fizik Luan Daci dhe personit fizik Ardian Hajdari, duke filluar nga viti 2011 e në vazhdim;
- Administrimin e bilanceve apo pasqyrave financiare gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit të avokatit, për secilin prej tyre;
- Të merret informacion pranë Drejtorive Rajonale Tatimore përkatëse, lidhur me atë se sa është shuma e detyrimeve tatimore të paguara nga zoti Luan Daci dhe Ardian Hajdari, duke filluar nga nisja e ushtrimit të aktivitetit dhe në vazhdim (TVSH, tatim fitimi, taksa, sigurime shoqërore dhe shëndetësore), si dhe cilat janë të ardhurat e tyre të deklaruar, të ligjshme;
- Informacion nga Drejtoria e Tatim Taksave pranë Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Shkodër, lidhur me personat fizikë Luan Daci dhe Ardian Hajdari, duke nisur nga viti 2000 e në vazhdim;
- Verifikimin pranë zyrave noteriale, ASHK, për kontrata të lidhura apo pasuri të rregjistruara apo proces legalizi nga këta persona.
- Administrimin dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore të diktuar nga dinamika e hetimit.

IX. Burimet e provave

1. Dokumentacioni i Administruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me shkresën me nr. 1825/2, datë 06.06.2019, në përgjigje të kërkesave të përsëritura të kallëzueses Antoneta Sevdari për shtetasit Ardian hajdari dhe Luan Daci, ku përfshihet edhe procesverbali i mbledhës së Komisionit AD Hoc date 02.06.2017;
2. Kopje të deklarata të pasurisë, para fillimit të detyrës të publikuara online, për shtetasit Luan Daci dhe Ardian Hajdari;
3. Disa të dhëna apo dokumenta identifikuese, procese gjyqësore ku shtetasit Luan Daci dhe Ardian Hajdari, kanë marrë pjesë;
4. Protokoll i kualifikimit të kandidatëve, miratuar nga Avokati i Popullit;
5. Ekstrakt historik i të dhënave të publikuara online nga QKB, për personat fizikë Ardian Hajdari dhe Luan Daci;

Evis D. D. D.
[Signature]

KALLËZUESIT

Antoneta Sevdari

[Signature]

Elisav Sevdari
[Signature]